



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VII
Sesioni vjeshtor

Seanca e jashtëzakonshme e Kuvendit
SJ-046
Prishtinë, 5 janar 2021, ora 18:00

PROCESVERBAL

**I SEANCËS SË JASHTËZAKONSHME TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 5 JANARR 2021**

Seancën e jashtëzakonshme e kryesoi Vjosa Osmani-Sadriu, kryetare e Kuvendit.

Kryetarja e Kuvendit, Vjosa Osmani-Sadriu i hapi punimet e seancës së jashtëzakonshme sipas kërkesës së kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Avdullah Hoti, me këtë rend dite: *Shqyrtimi i Propozim-Vendimit të Qeverisë për dërgimin e Kontingjentit të Forcës së Sigurisë së Kosovës jashtë vendit.*

Kryetarja i njoftoi deputetët se Propozim-Vendimi i Qeverisë nuk u është shpërndarë deputetëve 3 ditë pune para shqyrtimit në seancë plenare, andaj shqyrtimi i tij duhet të bëhet me shmangie nga afati i paraparë me nenin 15, paragrafi 7 të Rregullores së Kuvendit.

Pastaj, kryetarja kërkoi nga deputetët që me ngritje dore të deklarohen për shmangien nga afatet e parapara me Rregulloren e Kuvendit për shqyrtimin e Propozim-Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Rezultati i votimit ishte:

Për ----- 84,
Kundër -----0,
Abstenime ----- 0.

Kuvendi vendosi që shqyrtimi i propozimit për dërgimin e kontingjentit të Forcës së Sigurisë së Kosovës jashtë vendit të bëhet me shmangie nga afati i paraparë në nenin 15, paragrafi 7 të Rregullores së Kuvendit.

Pastaj, kryetarja procedoi me pikën e vetme të rendit të ditës:

1. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit të Qeverisë për dërgimin e Kontingjentit të Forcës së Sigurisë së Kosovës jashtë vendit

Kryetarja i njoftoi deputetët se Komisioni Funkcional për Çështjet të Sigurisë dhe Mbrojtjes e ka shqyrtuar këtë Propozim-Vendim dhe i ka rekomanduar Kuvendit që ta miratojë.

Pastaj, ajo e ftoi kryeministrin e Republikës së Kosovës, z. Avdullah Hoti, që ta paraqesë dhe ta arsyetojë Propozim-Vendimin.

Kryeministri Avdullah Hoti e paraqiti dhe e arsyetoi propozim-vendimin e Qeverisë së Kosovës për dërgimin e Kontingjentit të Forcës së Sigurisë së Kosovës jashtë vendit, si dhe kërkoi nga deputetët që ta miratojnë atë.

Diskutimi i plotë i kryeministrit është dhënë në transkript.

Në lidhje me Propozim-Vendimin e Qeverisë diskutuan: ministri i Ministrisë së Mbrojtjes, Anton Çuni, dhe deputetët: Fatmire Kollçaku, në emër të Komisionit funksional për Çështjet e Sigurisë dhe Mbrojtjes; Liburn Aliu në emër të GP të LVV-së; Arben Gashi, në emër të GP të LDK-së; Ganimete Musliu, në emër të GP të PDK-së; Daut Haradinaj, në emër të GP të AAK-së dhe Endrit Shala, në emër të GP Nisma-AKR-“6+”, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas diskutimeve, kryetarja kërkoi nga deputetët që me ngritje dore të deklarohen për Propozim-Vendimin e Qeverisë për dërgimin e Kontingjentit të Forcës së Sigurisë së Kosovës jashtë vendit.

Rezultati i votimit ishte:

Për ----- 92,
Kundër -----0,
Abstenime ----- 0.

Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

1. Kontingjenti i Forcës së Sigurisë së Kosovës dërgohet jashtë vendit me mision në ofrimin e mbështetjes së stabilitetit rajonal dhe operacione paqeruajtëse në regjionin e Komandës Qendrore Amerikane - U.S. Central Command (USCENTCOM).
2. Vendimi i dërgohet u.d. Presidentit të Republikës së Kosovës për dhënien e autorizimit për dërgimin e Kontingjentit të FSK-së.

Kryetarja i mbylli punimet e seancës së jashtëzakonshme në orën 19:20 minuta.

Vjosa OSMANI-SADRIU

Kryetare e Kuvendit

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale

P.S.:

Ky procesverbal nuk është miratuar për shkak të shpërndarjes së Legjislaturës VII, më 6 janar 2021.